

Në Pogradec fiton e majta

Zgjedhjet e 8 majit sollën surpriza në Pogradec e në gjithë rrethin. Një pjesë e atyre që mendonin se do të fitonin, fituan, ndërsa të tjerë u zhgënjyen, pasi nuk e prisnin verdiktin e popullit. E majta në Pogradec korri një sukses, pasi ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, ajo e shtriu dominimin e vet edhe në disa komuna ku qeverisnin të djathtët prej vitesh.

Kandidati demokrat për bashkinë e Pogradecit, Luan Topçiu, megjithë fushatën e moderuar e të qytetëruar, nuk arriti dot t'i mbushte mendjen elektoratit për votën, i cili nga ana e vet e kishte ndarë mendjen tek kryetari aktual Artan Shkëmbi, që fitoi një mandat të tretë për qytetin. Ashtu siç pritej e flitej, megjithë pakënaqësitë edhe të një pjese të socialistëve të rrethit, z. Shkëmbi triumfoi me 7580 vota, kundrejt 5837 vota të Topçiu, ose 1743 vota më tepër.

(faqe 2)



FITUESIT E 8 MAJIT

Pashkia Pogradec:	Artan Shkëmbi	PS
Komuna Proptisht:	Fuat Fero	PS
Komuna Velçan:	Ilir Mani	i pavarur
Komuna Trebinjë:	Feim Jasharllari	LSI
Komuna Buçimas:	Roshi Tollozhina	LSI
Komuna Udënisht:	Durim Toska	PS
Komuna Rrajcë:	Haxhi Çollaku	PS
Komuna Stravaj:	Ardian Zeneli	PD
Bashkia Përrenjas:	Bajazit Karriqi	PD



Mehmet Isufi, ikja e një njeriu të mirë

**Gjeneral
Brigade Dhori
Spirollari, një
mokrar
i mençur në
forcat e
armatosura
shqiptare**



NGJYRAT E DASHURISË

Galeria e Arteve – Pogradec, pranë Qendrës Kulturore “Lasgush Poradeci”



FALENDERIM!

Redaksia e gazetës “Mokra” falenderon Avokatin Agim Hoxha, lindur në fshatin Udënisht Pogradec, banues Durrës për sponsorizimin e këtij numri të gazetës “Mokra”.

*Driloni,
destinacion
turistik
i verës*





Artan Shkëmbi - bashkia Pogradec



Roshi Tollozhina - Buçimas



Ilia Mani - Velçan

8 maji, në Pogradec fiton e majta

Zgjedhjet e 8 majit sollën surpriza në Pogradec e në gjithë rrethin. Një pjesë e atyre që mendonin se do të fitonin, fituan, ndërsa të tjerë u zhgënjyën, pasi nuk e prisnin verdiktin e popullit. E majta në Pogradec korri një sukses, pasi ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, ajo e shtriu dominimin e vet edhe në disa komuna ku qeverisnin të djathtët prej vitesh.

Kandidati demokrat për bashkinë e Pogradecit, Luan Topçiu, megjithë fushatën e moderuar e të qytetëruar, nuk arriti dot t'i mbushte mendjen elektoratit për votën, i cili nga ana e vet e kishte ndarë mendjen tek kryetari aktual Artan Shkëmbi, që fitoi një mandat të tretë për qytetin. Ashtu siç pritej e flitej, megjithë pakënaqësitë edhe të një pjese të socialistëve të rrethit, z. Shkëmbi triumfoi me 7580 vota, kundrejt 5837 vota të Topçiu, ose 1743 vota më tepër. Në krye të bashkisë së Pogradecit për dy mandate ai ia ka ndryshuar pamjen qytetit dhe njëherësh ka fituar besimin e një pjese të konsiderueshme të bashkëqytetarëve. Premtimet e tij elektorale synojnë për një vijimësi reformash dhe ndryshimesh, aq të pritura për

qytetarët. Pogradeci ka ende nevojë për një qeverisje të mirë, për ndryshime e zhvillim e premisat janë për të qenë i tillë.

Duke u ndalur tek kjo bashki, vlen të theksojmë se edhe kandidati për këshillin bashkiak z. Petrit Shuli, për të cilin gazeta "Mokra" u bë një mbështetje gjatë fushatës, fitoi një vend për këtë këshill me mbi 300 vota dhe do të përfaqësojë partinë... Tashmë edhe zëri i M okrës do të ndihet në atë këshill.

Në komunën e Buçimasit, Roshi Tollozhina, ashtu siç pritej, nuk e diskutoi fare fitoren e tij, gjë që flet për punën dhe programin e qartë, shpresën dhe optimizmin që kanë vetë banorët tek qeverisja e tij. Ai fitoi me 4489 vota, kundrejt 3059 votave të kandidatit të majtë Valter Agora, ose me 1430 vota tepër, shprehje kjo e epërsisë dhe e popullaritetit që gëzon kryetari i komunës së Buçimasit, Roshi Tollozhina.

E përsëriti fitoren edhe Feim Jasharllari i "Aleancës së Qytetarit", i cili pas atij mandati të shkurtër 8 mujor, fiton mandatin e parë të plot me 855 vota, kundrejt 727 votave të kandidatit socialist Safet Doce. Por për Feimin mbetet shumë

punë, pasi koha ecën shpejt dhe duhet të kalojë nga premtimet elektorale te veprat, puna konkrete.

Në komunën e Velçanit Ilia Mani hyri për fitore dhe doli i fituar nga këto zgjedhje. Edhe pse nuk mori besimin e forcës politike që e kishte kandiduar në zgjedhjet e 2007-s, ai kishte besim tek aftësitë e veta, tek drejtimi që i kishte bërë komunës për katër vjet, tek programi si dhe tek mbështetja e banorëve të komunës së tij. Ata e njihnin Ilian, sikurse njihnin ndihmën, kujdesin dhe besën e tij. Edhe pse i pavarur, pasi dy partitë politike, me lojërat e tyre, nuk shfaqën interes tek ai, por që i bënë hesapet gabim. Të dy kandidatët, si ai i djathtë e i majti nuk mundën dot të sfidojnë kandidatit e pavarur Ilia Mani, i cili fitoi me 686 vota, kundrejt 460 votave të socialistit Maliq Musliu, ose 226 votave më tepër dhe 524 votave të demokratit Sali Torra, ose 162 vota më shumë. Kështu Ilia Mani merr besimin e Velçanit për një mandat të dytë, kësaj here si i pavarur, por më i fortë e më i bindur tek forcat, aftësitë dhe përvoja e tij. Motoja "Vijojmë së bashku" ishte premisë për fitoren, shpresë për një ditë edhe më të mirë.

Krejt ndryshe situata në ko-

munat e tjera. Socialistët i fituan të gjitha, edhe komunën e Udënishtit, me Durim Toskën me 2144, kundrejt kryetarit Nexhmi Dokollari i "Aleanca për Qytetarin" me 1451 vota. Diferenca është e dukshme dhe s'ka nevojë për koment. Nexhmiu kandidonte për të tretën herë radhazi dhe, mesa kuptohet edhe komuniteti e kishte braktisur dhe nuk mjaftojnë vetëm fjalët e premtimet, kur në zgjedhjet e 2007 kishte fituar me mbi 1200 vota diferencë. Me Në komunën e Çërravës fitoi Reshit Fraholli me 2241 vota, kundrejt Vladimir Jaçellit me 2127. Në Dardhas po ashtu fitoi kandidati socialist, Aleksandër Çela me 901 vota, kundrejt ish-kryetarit demokrat Rushan Çela me 770 vota.

Në Proptisht Fuat Fero sfidoi Shaban Sulën me një rezultat fatal për të, vetëm me 13 vota diferencë. Ishte një fitore e papritur për Feron, pasi Shaban Sula luftonte për mandatin e tretë dhe me vetëbindje se do të fitonte edhe kësaj here, por që i kishte bërë hesapet gabim. Humbja e Shaban Sulës në një farë mënyre ishte e pritshme. Ata banorë nuk mund të pranenin më të drejtosheshin nga një model i dështuar kryetari, një model që kishin inves-

tuar për dy mandate, që i kishin besuar e që nuk mund t'i besonin më. Njerëzit u lodhën me premtimet pa karar, u lodhën nga tallja, moskokëçarja, fyerjet, sharjet publike, dhe deri imazhi prej të dehuri, jo nga sukseset, por nga pija, që ofronte kryetari. Më vjen keq edhe si gazetë kemi përkrahur kandidimin e tij më parë, por për fat ët keq Proptishti ofron një amje të mjeruar, zyrat gjithashtu. Aty u investua tek një grusht njerëz që hanin e pinin, jo tek populli që mbeti rrugëve e s'kishte kujt t'i qahet e t'i ankohej. Banorët e Proptishtit zgjedhën Fuatin, me shpresën se do gjejnë një njeri që të paktën t'i dëgjojë, t'u qajë hallin, do të gjejnë një derë të hapur zyre, jo klubi. Fuat Fero fitoi me 1362 vota, kundrejt 1349 votave të kandidatit demokrat.

Për PD-në e Pogradecit këto zgjedhje ishin një dështim, pasi akoma nuk e kanë kuptuar se në zgjedhjet lokale është kandidati që vendos, jo partia, është njeriu, jo paratë, tarafet apo klanet. Humbja që pati rrethi në këto zgjedhje shpresojmë të reflektohet dhe që të shkohet në zgjedhjet e tjera me mend në kokë, me njerëzit e duhur.

F. SLATINA



Fuat Fero - Proptisht



Feim Jasharllari - Trebinjë



Aleksander Çela - Dardhas



Reshit Fraholli - Cerravë

ZGJEDHJET 2003					
Nr.	Emri i kandidatit	Subjekti	Vota	%	Zgjedhes
HUDENISHT					
1	Nexhmi Dokollari	PD	1098	39.77	4326
2	Gafur Avdullari	PS	1534	55.56	2754
					67.48%
PROPTISHT					
1	Shaban Sula	PD	1530	57.11	4504
2	Zihni Bufi	PS	1065	39.75	2685
					63.17%
TREBINJE					
1	Bujar Sofi	PS	863	43.90	3195
2	Azbi Muco	PD	498	25.33	1966
3	Gjergji Buzo	PDS	558	28.38	63.79%
VELCAN					
1	Kristian Menkshi	PD	241	13.79	2716
2	Ramazan Rapçe	PS	959	54.86	1748
3	Petrit Cela	PDS	535	30.61	67.45%
BASHKIA					
1	Artan Shkempi	PS	4897	54.99	24808
2	Sotiraq Ambro	PD	2664	29.92	8801
3	Gjergji Ilo	I pavarur	675	7.58%	38.35%
BUCIMAS					
1	Besnik Jacelli	PD	3265	60.87	9790
2	Perparim Latifllari	PS	1651	30.78	5364
3	Lorenc Gora	PSD	232	4.33	57.23

ZGJEDHJET 2007					
Nr.	Emri i kandidatit	Subjekti	Vota	%	Zgjedhes
HUDENISHT					
1	Nexhmi Dokollari	PD	1995	65.13	4343
2	Gafur Avdullari	I pavarur	794	25.92	1465
3	Arben Alilaj	PS	210	6.86	66.71%
PROPTISHT					
1	Shaban Sula	PD	1615	57.60	4394
2	Safet Xhyra	PS	1172	41.80	2851 vota
3	Ilmi Leka	PBDNJ	17	0.61	65.07%
TREBINJE					
1	Gjergji Buzo	PS	740	49.76	2443
2	Genci Muço	PD	726	48.82	1507
3	Bardhosh Qose	PBDNJ	21	1.41	61.69%
VELCAN					
1	Ilia Mani	LSI	721	45.75	2406
2	Avni Mara	PD	629	39.91	1620
3	Hamza Karasaliu	PBDNJ	226	14.34	67.54
BASHKIA					
1	Artan Shkempi	PS	6220	54.93	28003
2	Shpetim Guxholli	PD	4909	43.35	12001
3	Sulejman Hyskollari	PKSH	115	1.02	42.83
BUCIMAS					
1	Roshi Tollozhina	LSI	2193	37.71	11102
2	Vasfi Dulellari	PD	2026	34.884	5896
3	Erzen Qeva	I pavarur	1516	26.07	53.89
3	Erzen Qeva	I pavarur	1516	26.07	53.89



Portreti i paautorizuar i një kryetari të ri komune

Nga Bora Shahini

Edhe pse e votuan shumë, jo të gjithë e besonin se Fuat Fero do të ishte kryetari i ri i komunës së Proptishtit. Rezultatet, pas numërimit të votave, e nxorën fitueses me një rezultat të ngushtë, vetëm 13 vota kundër rivalit dhe kryetari aktual të komunës z. Shaban Sula. Fuat Fero vetëm pas pak javësh do të ulet në karrigen e kryetarit të ri të kësaj komune. Ai ashtu sic ka premtuar, kërkon t'i kthejë dinjitetin banorëve të kësaj komune. Ai shprehet se do të bëjë reforma të mungua në komunë, për të qenë sa më afër banorëve që e zgjedhën, që i dhanë atij mundësinë, besimin dhe forcën për t'i drejtuar. Një bashkëshort dhe një prind i mirë i tre fëmijëve, fjalëpak, i bindur dhe i ndërgjegjshëm në ato që premtonte, Fuati shpreson të ndërtojë një model të ri të kryetarit, që Partinë ta shikojë jo si një mburojë, por si një mundësi dhe si një forcë. Kjo mundësi do e mbështesë atë të realizojë premtimet dhe projektet e komunës, në dobi të popullit të vet, duke investuar për vlerat

shpirtërore që po zhdukeshin gradualisht. Banorët e komunës, jo të gjithë, natyrisht, e mirëpritën këtë zgjidhje si një dëshirë për ndryshim. Gjatë një intervistë me të ai është shprehur se ndryshimi do jetë i menjëhershëm. Gjëja e parë me të cilën ai do të merret, për të mos humbur kohë është përzgjedhja e administratës. "Do vendos në administratë njerëz të aftë, të profileve të tyre dhe që dinë ta bëjnë më së miri atë gjë. Sigurisht, që reciproke është kërkesa e llogarisë dhe kjo gjë nuk do mungojë." Njerëzit besuan tek ai, jo tamam si "të vetmen rrugë" për Proptishtin, por si si të vetmin person që mund të bënte diçka ndryshe, për të qenë nesër një kryetar për të gjithë, pa i ndarë njerëzit. Zgjedhësit i besuan Fuatit se shohin tek ai njeriun punëtor, të drejtë, që gjithçka e ka me djersën dhe mundin e tij. Të gjithë e njohin mësuesin, bashkëfshatarin, familjarin, njeriun e partisë, kryeplakun, shokun, mikun, por mbi të gjitha njohin Fuatin që i ka të gjitha këto e që diti t'i shfrytëzojë më së miri në dobi të kauzës së tij. Ka ikur koha kur njerëzit votojnë për partitë, banorët janë treguar të zgjuar sepse dinë të zgjedhin

dhe kësaj here kërkojnë një drjetues që s'do t'i zhgënjëjë, që do dijë t'i mbajë premtimet e ofruara e që do t'i përfaqësojë ata me dinjitet. Ai e di shumë mirë tashmë që ka fituar zemrat e njerëzve, madje edhe të atyre me bindje të kundërta politike. Di shumë mirë se ç'duhet të bëjë, madje ai na pohoi edhe se nga do ia niste. Një ndër vijuesmeritë e tij do të jetë edhe lidhja e kryesive të fshatrave me komunën. Mendon se problemet e fshatrave duhet t'i bëjnë të ditur kryepleqtë përkatës, për ta ushtruar problemin në komunë dhe do të jetë e dukshme dispozicioni për zgjidhjen e menjëhershme të tyre. "Më pas në varësi të fondeve që do të jenë për komunën tonë do fillojmë më zgjidhjen e problemeve imediate". Fuati ka zgjuarsinë, vullnetin, mundësinë dhe dëshirën për të punuar, do të dijë të vëjë në lëvizje komunën dhe shpresoj që t'u kthejë besimin banorëve që e besuan. Vetëm se duhet të ketë mendjen që të zgjedhë njerëz të mirë me të cilët do punojë, ndryshimi duhet të fillojë nga aty, sepse njerëzit janë të lodhur e të munduar, ndaj komuna ka nevojë për vizione e njerëz të rinj!



Nr.	Njësia vendore	QV	Zgjedhes	Vende ne keshill
1	BASHKIA POGRADEC	28	29751	25
2	KOMUNA BUCIMAS	15	11282	17
3	KOMUNA CERRAVE	11	7036	15
4	KOMUNA DARDHAS	8	2440	13
5	KOMUNA HUDENSHT	9	5320	15
6	KOMUNA PROPTISHT	13	4680	15
7	KOMUNA TREBINJE	9	2457	13
8	KOMUNA VELCAN	9	2528	13
Surr		8	102	65494



Bajazit Karriqi

Në Përrenjas e në Rrajcë, kryetarë të rinj

Ndryshe nga Pogradeci, Librazhd, në Stravaj, në Qukës etj. Bajazit Karriqi i PD-së do të jetë kryetari i bashkisë së Përrenjasit për katër vitet e ardhshme, duke zëvendësuar Topin, i cili e mbylli mandatin brenda katër vitesh. Po ashtu edhe Selajdin Bogdani i komunës Rrajcë e mbylli me katër vjet drejtimin e komunës, duke u zëv-

endësuar nga Haxhi Çollaku i PS-së. Ndryshe Ardian Zeneli i komunës Stravaj që fitoi mandatin e tretë në krye të komunës, duke konfirmuar reputacionin dhe punën e mirë që ka bërë në këto vite.

Gazeta "Mokra" shpreson të ndërtojë marrëdhënie me drejtuesit e rinj, duke i futur të jenë gjithmonë të pranishëm në faqet e gazetës sonë. Iu urojmë sukses në misionin e tyre, në shërbim të qytetarëve që i zgjedhën e i besuan!



Për herë të parë "Pogradeci", me 68 pikë, është shpallur kampion i Kategorisë së Parë dhe në sezonin e ri, 2011-2012 do të jetë pjesë e superligës, me 14 skuadra. Gjate të gjitha ndeshjeve që zhvilloi në këto gara të forta dhe interesante, skuadra e Pogradecit e udhëhequr nga Presidenti Artan Shkëmbi që njëkohësisht është edhe Kry-

etari i Bashkise së Pogradecit dhe e drejtuar me mjeshtri nga trajneri Ylli Cekiçi tregoi përgatitje, seriozitet dhe vendosmëri për të mbërritur e para në fund. Për shumë jave me radhe pogradecaret qëndruan në krye të klasifikimit me merite të plote. Në javën e fundit ata e zhvilluan takimin përmbylles me skuadrën e Burrelit duke fituar me re-

zultat 4-2. Për të dorëzuar medaljet dhe Kupën e titullit Kampion Kombëtar i Kategorisë së Parë, në Pogradec ishte Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit zoti Armand Duka i cili në një ceremoni interesante mes brohoritjeve të mijera sportdashësve, fishekzjarreve të fitores dhe flamujve të vëlvitur u ngjiti me protagonistet në

podin e fitores duke i urrear për sukses të metejshme. Në sezonin e ardhshëm Pogradeci do të rreshtohet midis 14 skuadrave me të mira të Shqipërisë në Kategorinë Superiore. Kjo është hera e katërt që qyteti liqenor prek këtë sukses në futboll. Me parë ata kanë qenë pjesë e elites së futbollit shqiptar në vitet 1967, 1969 dhe 1991.

Driloni, destinacion turistik i verës

Driloni dhe fshati Buçimas në rrethin e Pogradecit kanë bërë gjithë përgatitjet për të qenë një destinacion i preferuar turistik për sezonin e ri.

Kryetari i komunës Buçimas, Roshi Tollozhina tregon se me dy eskavatorë të Bordit Rajonal të Kullimit është pas-

truar bregu i Liqenit dhe nxjerrja e rërës në breg përgjatë plazhit, në një gjatësi 2.5 km nga Pogradeci deri në Drilon, bashkë me sistemimin e tij.

"Gjithashtu ka përfunduar sistemim-asfaltimi i rrugës përgjatë bregut të liqenit dhe Plazhit në Drilon dhe Buçimas, ku ka me dhjetra objekte hotelerike

dhe bare e restorante që ofrojnë shërbim cilësor", tha Tollozhina.

Ilirjan Belli, 50 vjeç nga Starova tregon dy zanatat e tij të preferuara, gatimi në guzhinë dhe peshkimi në liqen. "Duke peshkuar ushtrij sportin e bukur të peshkimit dhe njëherazi, furnizoj lokalim tim, ku vijnë shumë vizitorë", thotë ai.

Ndërsa Artan Mançelli 24 vjeç po nga fshati Starovë tregon se shëtitjet me varkë në liqen janë shumë të preferuara nga vizitorët vendas dhe të huaj. "Prandaj veç shërbimit në lokal, ofroj edhe këtë sport mjaft të preferuar", thotë ai.

Në lokalet përgjatë liqenit ofrohen gatimet tradicionale,

prodhime bio si korani dhe belushka, perimet e freskëta dhe tushitë, specat e mbushura dhe lakrori me dy petë, që pëlqehen shumë nga vizitorët.

Vjet, Driloni dhe Plazhi i Buçimasit u vizituan nga mbi 20 mijë vizitorë vendas dhe të huaj. Këtë vit synohet që ky numër të dyfishohet



Gjeneral Brigade Dhori Spirollari, një mokrar i mençur në forcat e armatosura shqiptare

Gjeneral Brigade Dhori Spirollari ka lindur në Mokër, Pogradec më 3 korrik të vitit 1958. Ai i përket atij brezi ushtarakësh të cilët kanë kryer fillimisht arsimin e mesëm ushtarak në Shkollën e Mesme "Skëndërbej". Ai filloi këtë shkollë në vitin 1973 dhe e përfundoi në vitin 1977, dhe filloi studimet e larta në Shkollën e Lartë Ushtarake, dega kundërajor. Këto studime i përfundon në vitin 1981, vit në të cilin emërohet edhe oficer dhe kryen detyrën e komandantit të togës deri në vitin 1982. Më pas, ai merr detyrën e komandantit të batërisë deri në vitin 1985. Nga ky vit, në periudhën 1985-1990 ai do të punojë si pedagog në Shkollën e Lartë të Bashkuar të oficerave, dhe do të ngrihet në pozitë, nga viti 1990 deri në vitin 1991, kur merr detyrën e Shefit të Departamentit në Akademinë Ushtarake.



Shtabin e Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes dhe nga viti 2007 ai merr detyrën e zv.komandantit të Brigadës Ajrore për tu bërë më pas Komandant në Detyrë i Forcave Ajrore (Brigada Ajrore) nga viti 2008 deri në vitin 2009. Nga muaj janar i vitit 2010, gjeneral Dhori kryen detyrën e komandantit të Forcave Ajrore.

Në fushën e arsimit ai ka kryer Akademinë e Mbrojtjes, në vitet 1991-1993, Akademinë e Lidershit, Hamburg, Gjermani, në vitet 2001-2002, në vitin 2002 kryen kursin European, Hamburg, Gjermani dhe në vitin 2006 ai kreu Kolegjin Ndërkombëtar të Sigurisë "George C. Marshall". Gjeneral Spirollari njihet fërgjisht, anglisht dhe gjermanisht, ka përfunduar edhe studimet për filozofi në 1987 në Universitetin e Tiranës.

Gjeneral Dhori Spirollari qëndron në krye të Forcave Ajrore, një forcë të e

“ Të punosh me njerëz të tillë pilotë, është një krenari dhe gjeneral Dhori me qëndrueshmërinë dhe seriozitetin që e karakterizon është përfaqësues dinjitoz i një arme dinjitoze dhe me traditë të merituar, ashtu siç është Forca Ajrore. ”



GJENERAL BRIGADE DHORI SPIROLLARI, me z. ZENUN FERRO e z. ZABIT CUKU, MAJ 2010

cila pasqyrohet simboli i qiejve, sakrificës profesionale, rrezikut dhe lirisë. Në shtator të vitit 2010 merr gradën Gjeneral Brigade. Pilotët e Forcave Ajrore kanë qënë të parët në dhënien e asistencës, në të gjitha emegjencat civile duke mos kursyer e duke mos marrë parasysh herë-herë as edhe kushtet e vështira apo orët e tej zgjatura të

fluturimeve që kishin kryer. Të punosh me njerëz të tillë pilotë, është një krenari dhe gjeneral Dhori me qëndrueshmërinë dhe seriozitetin që e karakterizon është përfaqësues dinjitoz i një arme dinjitoze dhe me traditë të merituar, ashtu siç është Forca Ajrore.

Zenun FERRO
Zabit CUKU

PROGRAMI I USAID-it PËR INFORMATIZIMIN E BASHKISË SË POGRADECIT

Nga Erion CUKU

Bashkia e Pogradecit ka filluar informatizimin e plotë, në lidhje me të gjitha shërbimet për qytetarët dhe bizneset taksapagues. Ky model që po aplikohet me mbështetjen e USAID është shtrirë edhe në 10 bashki të tjera të vendit.

Ky informatizim krijon lehtësiara për sa i përket marrëdhënies së bashkisë me bizneset dhe me qytetarët, dhe lehtësirat që i afrohen këtyre grupeve.

Në këtë program Bashkia krijon mundësinë që qytetarët të marrin përgjigje për nevojat e tyre në qendrat e njësive administrative, si dhe në një rrjet kioscash informuese që po installohen në qytet.

Sistemi, i cili po zhvillohet përmes Programit të USAID-it për qeverisjen vendore në Shqipëri, (LGPA), mundëson një administrim më eficient dhe më

efikas të vjeljes së tatim-taksave dhe afërimit të shërbimeve.

Drejtori i USAID-it David Smith, ka premtuar se ky program do të shtrihet me shpejtsi në Bashkinë e Pogradecit, e në shumë bashki të tjera të vendit. Projekti do të realizohet me faza, faza e parë përfshin, ndërtimin e sistemit të menaxhimit financiar, burimeve njerzore dhe pagat, platformën e tipit ERP (planifikimi i resurseve të institucionit). Faza e dytë ka të bëjë me ndërtimin e një platforme të integruar të tipit CRM (administrimi i kontaktit të informatizuar me qytetarët dhe bizneset).



Kryetari i Bashkisë së Pogradecit, Artan Shkëmbi

Faza e tretë që është në proces ka të bëjë me krijimin e një rrjeti të përbashkët me të gjitha institucionet e tjera.

USAID, do të punojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që t'i mundësojë njësive të qeverisjes ven-

dore akses në të dhënat elektronike të qarkullimit të tatimpagusit, bazuar në të dhënat e kasave rregjistruese për ato biznese që ndodhen brenda kufijve të tyre teritorialë.

USAID ka prezantuar sistemin e ri të kompjuterizuar të tatim-taksave vendore më 6 shkurt 2011, në nënë të bashki, duke përfshirë edhe bashkinë e Pogradecit.

Programi i USAID-it për qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) po punon për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë vendore, për përmisimin e qeverisjes vendore dhe për fuqizimin e pjesmarrjes dhe rregullat e angazhimit të shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin vendor.

Jani Basho firmosi i pari, letrën që studentët shqiptarë i shkruanin presidentit Wilson

Nga Jovan BASHO, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës

Pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe fitimit të pavarësisë Kombëtare (28.11.1912) Shqipëria u njoh si shtet i pa varur më 22 janar 1913 (Konferenca e Ambasadorëve në Londër), por gjysma e saj kishte mbetur jashtë kufijve territoriale të caktuar në këtë konferencë. Brenda vendit anarki e plotë: Qeveria e Ismail Qemalit në Vlorë e kundër saj Qeveria e Esad Pashë Toptanit në Durrës. Grekët shkelën dhe shkretuan Shqipërinë e Jugut, serbët pushtuan Shqipërinë e Veriut, malazetët hynë në Shkodër. Princ Wied, i cili u dërgua si mbret i Shqipërisë prej fuqive të mëdha, zbriti në Durrës në 7 mars të vitit 1914 dhe u shtërgua të largohej në fillim të shtatorit të atij viti. Lëvizja e Rebelëve në Shqipërinë e Mesme dhe veprimet e grekëve në Shqipërinë e Jugut e bënë të pa mundur organizimin e shtetit shqiptar. Në këtë kohë plasi Lufta e Parë Botërore (korrik 1914) dhe Shqipëria u shkel prej ushtrive ndërluftuse austro-hungareze, italiane dhe franceze.

Me mbarimin e Luftës e Parë Botërore, problemi shqiptar ishte akoma më i koklavitur: Traktati i fshehtë i Londrës (nënshkruar më 26 prill 1915) kishte vendosur copëtimin e Shqipërisë midis Italisë, Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Lufta e Parë Botërore mbaroi në nëntor të vitit 1918. Në dhjetor të po këtij viti u formua qeveria e Durrësit nën Turhan Pashë Përmetin që u zevëndësua nga qeveria e Tiranës e dalë nga Kongresi i Lushnjës (21 janar 1920).

Në vazhdim të politikës antishqiptare Italia nënshkroi me Greqinë marrëveshjen Tittoni-Venizelos (1919), e cila i njëjtte Greqisë kërkesat mbi Shqipërinë e Jugut me kusht edhe Greqia



të njëjtte sundimin Italian mbi pjesën tjetër të Shqipërisë.

Në këto rrethana historike u mblodh Konferenca e Paqes në Paris më 1919. Austria që kishte influencuar dhe mbështetur aq shumë pavarësinë e Shqipërisë kishte humbur luftën. Nga ana tjetër fuqitë fituese (Anglia, Franca dhe Rusia) mbështetën hapur shtetet fqinje të interesuar për tu zmadhuar me territore shqiptare. Kështu, Shqipëria nuk kishte më asnjë përkrahje të jashtme, përveç zërit të fuqishëm të Presidentit Willson të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili mbrojti të drejtën në dobi të kombit shqiptar.

Letra që po paraqesim është shkruar nga studentët shqiptarë që studiojnë në Universitetin e Vjenës dhe i është dërguar Presidentit Wilson në Paris, kjo është sot një mister, por letra mban datën 15.12.1918 dhe përbën pa asnjë



Doktor Jani BASHO ishte iniciator i ndërtimit të Spitalit Civil dhe Spitalit Usharak më 26 shtator 1929. Në historinë e drejtimit të Spitalit Usharak, nga themeluesi e drejtoi nënkolonel Doktor Jani BASHO (1923-1935)

dysim përpjekjen e parë serioze për ta bërë të njohur problemin shqiptar tek Presidenti Wilson.

Nënshruesi i parë ishte Dr. Jani Basho (1892-1957) asokohe student në Fakultetin e Mjekësisë dhe kryetar i shoqatës së studentëve shqiptarë "Albania". Ai i kishte thënë babajit tim Kozma Basho (1927-1994) se pas marrjes së letrës, presidenti Wilson kishte dërguar në Vjenë ambasadorin Calvin Coolidge (më vonë President i SHBA) për t'u takuar me studentët shqiptarë. Zoti Coolidge i priti këta studentë në një kështjellë në periferi të Vjenës (1919) dhe u deklaroi atyre që zëri i Presidentit Wilson në Konferencën e Paqes do të ishte në përkrahje të vendit të tyre. Në vitin 1920, po këta studentë i dërguan një notë Konferencës së Paqes në Paris, pikërisht për këto arsye.

Nga ana tjetër për të parë gjendjen në

vend, ai dërgoi në Shqipëri konsullin e SHBA në Torino, zotin Jozef Haven (1919) i cili vizitoi Shqipërinë e Jugut dhe të mesme duke u shoqëruar nga patrioti Tefik Mborja. Raporti që ai dërgoi Presidentit Wilson ishte tërësisht pro Shqipërisë. Studentët e shqiptarë e përfundojnë letrën drejtuar presidentit Wilson:

"Zotëri! Ju lutemi në emër të djelmërisë shqiptare e të kombit shqiptar, ta merrni këtë fakt komb fatkeq nën mbrojtjen Tuaj. Në emër të studentëve shqiptarë në Vjenë,,"

Të përvuajturit. cand.med Jani BASHO, cand. Bodenkultur, Remzi BAÇI, cand. ing H.HIFVZI, cand.jurist, Nush BUSHATI, student phil Djevat KORÇA, cand.Ekxport akademik Luigj KAKARRIQI, student inxhinier Gjovalin GJIADRI, Aspirant pharm Raku BUDA, student inxhinier Fuad ASLAN VIENË, AUSTRI 15/12/1918

Me rastin e 72-vjetorit, 16 prill 1939 ku ushtarakët shqiptarë refuzuan betimin e Musolinit, në Romë.

Oficeri shqiptar Reshit Çollaku refuzoi betimin e Musolinit

Nga Zenun FERRO

Reshit ÇOLLAKU lindi në vitin 1914, në Pogradec rrjedh nga një familje mokrre, nga fshati Laktesh, që ka shkuar në Pogradec. Pasi baroi shkollën fillore, prindërit, e dërguan që të vazhdonte studimet më tej.

Në vitin 1929, Reshit Çollaku vazhdon shkollën Mbretërore ushtarake në Tiranë, dhe e mbaroi në vitin 1933. Pas kësaj në vitin 1933 Reshiti u nis për studime në Itali bashkë me 30 studentë shqiptar, në Romë, në Kolegjin Usharak vazhdoi të zgjeronte kulturën e tij. Pas mbarimit të Akademisë në vitin 1938, si mori gradën nëntoger, hyri në Aplikacion, në Parma.

Më 5-6 prill 1939 radio Moska njoftonte se Italia Fashiste po bënte përgatitje për të zbarkuar në Shqipëri. Më 7 prill ai takoi një Italian antifashist, dhe i jep revolverin që i kishte dhuruar, duke i thënë: Merre prapë dhuratën, spse fashizmi italian po shkel Atdheun tim. Unë, si Shqiptar, kam për detyrë të luftoi kundër pushtuesëve. Ti, si ushtar, mund të detyrosh të vish në Shqipëri, atëhere do të ishte një gjë e shëmtuar dhe e padëshiruar për mua të të vras me armën tëndë që ma ke dhuruar. (Nexhat Hyseni "Reshit Çollaku,, Tiranë, 1964, faqe 21)

Në mëngjesin e 7 prillit 1939 dëgjoji në radio se fashistët po zbarkonin në Shqipëri. Në dhomën e tij italianët nuk donte t'i shihte me sy, dhe u th ishte: "Gjer tani ju kam pasur



miq tani e tutje jemi armiq,, Ai lajmëroi oficerat e tjerë shqiptarë, për lajmin e keq, ata ulnin kokën, dhe s'mund të mbanin lotët. Në mbërmje radio Moska tha se populli Shqiptar po luftonte. Dëgjonte çdo lajm mbi qëndresën dhe kishte dëshirë të madhe që të vazhdonte lufta.

Në datat 7,8,9, prill 1939 oficerat Shqiptarë, në shenjë proteste nuk vajtën në mësim. Pasi u kërcënuan rëndë, ata, të vrejtur shkuan në mbledhjen që organizonte komandanti i shkollës. Kur komandanti fliste për "patriotizmin,, e njerzëve që e kundërshtojnë pushtimin Reshit Çollaku u ngriti dhe tha; se ata që përkrahin fashizmin janë tradhëtarë të dhjetë flamurëve dhe nuk përfaqësojnë popullin shqiptar,

Më 12 Prill 1939 të gjithë ushtarakët shqiptarë i mblodhën për të bërë betimin. Këtë Reshit Çollaku nuk e pranoi. Unë jam betuar një herë për Shqipërinë dhe një betim të dytë e quaj të turpshëm dhe korruptonjës.

Komanda italiane, pas një pune të madhe

përgatitore vendosi të bëjë betimin me madhësinë më të madhe. Koloneli fashist, pas një fjalimi të bujtshëm, i fton ushtarakët shqiptarë që të betohen përpara "flamurit kombëtar,, dhe pret. Asnjë shqiptar nuk doli për betim, Reshit Çollaku nga rrjeshti doli dy hapa përpara dhe nisi të flautë: "Na ndjeni, zotërimj, ky flamur nuk është i yni".

Për çdo shqiptar të vërtetë është krejt i huaj, prandaj ne s'kemi përse të betohemi përpara një copë beze të kuqe që ka aq vlerë sa edhe copat e bezeve me të cilat mbështjellim këmbët".

Koloneli fashist e kërcënoi Reshitin, duke i kujtuar detyrën si ushtarak.Po Reshiti vazhdoi prapë të flautë. Qëndrimin e Reshitit e përkrahën me vendosmëri edhe shumë ushtarakë të tjerë. U prish madhështia dhe Reshiti e futën nën arrest.

Por fashistët nuk u tërhoqën, donin me çdo kusht të thyenin qëndresën ushtarakëve shqiptarë, në Romë, Napoli, Torino, Parma, që studionin 158 vetë. I mblodhën të gjithë në Romë, që t'i bindin që këta të betoheshin për Mbretin Perandor dhe për Duçen, dhe këtë ta bënin para gjithë botës, që merrej vesh se Italia qe e ftuar dhe jo e luftuar në Shqipëri.

Më 16 prill 1939, në Kastel, Pretorio në Romë, do të bëhej betimi. Koloneli i paraqit forcën gjeneralit, duke i raportuar se 158 ushtarakët shqiptarë, ishin gati të bënin betimin. Gjenerali lexoi tekstin dhe, kur mbaroi ngriti shpatën lart duke bërë betimin: Lo giurate voi?! "A betoheni ju?!"

Nga ushtarakët shqiptarë asnjë përgjigje.

Në këtë rast Gjenerali pyeti kolonelin: - kolonel, dinë a s'dinë italisht këta shqiptarë? - Si nuk dinë gjeneral.

Gjenerali pas kësaj e futi shpatën në kllaf, shikoi egër ushtarakët shqiptarë që kishte përpara dhe thirri: "stiate attenti!,, (kini mendjen) Prapë nxori shpatën dhe në një zë të çjerrë përsëriti: Lo giurate voi?, po ushtarakët shqiptarë nuk vepruan,shpatatat e tyre rrinin në brez.

Gjenerali i çoroditur, shfryu: "Që prej 40 vjetësh që jam ushtarak, askush s'ma la mua shpatën në hava. Të gjithë të arrestohen"

Karabinerët u matën të arrestonin në vend 158 ushtarakët shqiptarë, por s'guxuan të afrohen dhe t'i prekin. Në sallat e tyre ushtarakët shqiptarë dorëzuan shpatat dhe uniformat.

Shkolla që vazhdonte Reshit Çollaku në qershor 1939 shkoi në kufirin francez për stërvitje, por atë e caktuan larg kufirit. Për shqiptarët në repartet italiane ishte zi atmosferë fyese, dhe Reshiti u largua u shtrua në një spital. Pas 3 muaj përpjekje për t'u larguar, dhe nxori shtatë ditë leje për në Shqipëri, me preteksin se kishte nënën sëmurë.

Shkoj në Pogradec dhe u arratis në shtator 1939 për në Jugosllavi, ku zhvilloi aktivitet politik, dhe në prill 1941 kthehet në Pogradec dhe fillon aktivitetin patriotik në Pogradec, Mokër, e Gorë. Për këto aktivitete është shkrojtur, por ka nevojë të shkruhet prapë. Ai ra heroikisht në luftë kundër fashizmit italian më 16 korrik 1943, në Pojskë, Pogradec në moshën 29 vjeçare.

Disiplina dhe ndëshkimi i fëmijëve

Nga Manjola LUSHKA



Disiplina dhe ndëshkimi, terma të cilët i dëgjojmë shpesh në jetën e përditshme, por që jo të gjithë nga ne e dine kuptimin e tyre të vërtetë. Për më tepër kur bëhet fjalë për disiplinën e fëmijëve, motrave apo vëllezërve tanë. Termin disiplinë shpeshherë ne e kuptojmë si dhunë e treguar ndaj fëmijëve tanë që ata të bëhen fëmijë të mirë e të sjellshëm, dhe në shumë raste kështu e përdorim. Ka shumë arsye pse prindërit bien në kurthin e ndëshkimit të fëmijëve të tyre. Ashtu siç ka edhe shumë që mendojnë se përgjegjisi e tyre është ti disiplinonin duke i ndëshkuar. Ndonëse krejt i kundërt është kuptimi i tyre i vërtetë. Në shkencat shoqërore thuhet: Disiplina është përgatitja e fëmijës në rrugën që duhet të ndjekë në jetë dhe mësimin e sjelljeve të duhura për të. Ndërsa krejt e kundërta ndodh me ndëshkimin, i cili është një nga format e dhunës ndaj fëmijëve, por kurrsesi, disiplinë. Sa më shumë të disiplinuar ta bësh një fëmijë aq më pak ndëshkim kërkohet ndaj tij. Një fëmijë i pranuar, dhe i dashur është padyshim i disiplinuar, por që ai të jetë i tillë patjetër që ngelet detyra jonë si prindër apo kujdestarë ta bëjmë atë të ndihet i dashur dhe i pranuar, në mjedisin social ku ai bën pjesë. Ka qark shumë shkrime që flasin për dashurinë, përkujdesjen, faljen, ndjeshmërinë dhe ngrohtësinë e fëmijëve, sa do të ishin ushqimi social dhe emocional më i mirë për ne dhe fëmijët tanë, që jeta e tyre të ndriconte. Sa mirë do të ishte sikur ti shikonim këto shkrime!

Natyrisht që nuk mund të zhdukim dhunën dhe dhunesit, po gjëja më e thjeshtë për ne është të ndërgjegjësohemi për të. Ka shumë të tjerë që janë partizanë të idesë, se dhuna është disiplinë. Dua të sjell këtu një shembull që besoj se te gjithë e dinë dhe njohin shkopin e bariut. Bariu e përdor shkopin për ti drejtuar delet dhe jo për ti rrahur ato. Ai me butësinë e tij i drejton delet, sidomos qengjat, thjesht për ti ndalur ato të mos shkonin në rrugën e gabuar, dhe me butësi i orienton në drejtimin e duhur. Ashtu duhet të jetë edhe një prind i mirë e i dashur për fëmijën e tij. Dashuria për fëmijët ekziston tek të gjithë, por ajo çfarë ne, na pengon ta pasqyrojmë është mënyra se si e reflektojmë tek ata. Edhe në bibël shkruhet për fëmijët. Apostulli Pal na udhëzonte: Dhe ju etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë dhe këshillë të Zotit. Prandaj të dashur prindër, mos i ngacmoni dhe mos i rrihi fëmijët tuaj, sepse zemërimi dhe inati i tyre, i bën ata më tepër kokfortë, kundërshtues, të padhemshur dhe mbi të gjitha kultivon tek ta ndjenjën e egozmit social.

Ne kemi shumë dëshirë, që fëmija ynë të jetë i sjellshëm, i zgjuar, i dashur, i këndahëm, por jo të gjithë janë kështu. Më e rëndësishmja është se që të kemi

fëmijë të tillë, patjetër që duhet të jemi edhe ne si ai që kërkojmë të shohim, ta duam, ti falim dashuri, dhe ta disiplinonim. Po sigurisht që ne harrojmë se ai nuk i ka mësuar ato, nuk i ka parë tek ne. Që të bëhemi model duhet të kemi një të tillë për ta parë. Pavarsisht se sa mirë e kryejmë ne detyrën si prindër, fëmija padyshim që do të silltet edhe keq, dicka e pa shmangshme në realitetin tonë. Prindër të përsosur dhe fëmijë të përsosur nuk ka, por të paktën të bëhemi të sjellshëm dhe tu falim dashuri, ti përgatisim për jetën dhe zhvillimi e tyre. Fëmija nga natyra e di, se sa shumë ka nevojë për dashuri dhe po nga natyra e tij, ai nuk përpiqet ta fitojë atë. E vetmja arsye, se është larg kapaciteti të zhvillimit të tij për ta kuptuar këtë domosdoshmëri. Është vërtet e vështirë ti shqyrtosh të gjitha nevojat e një fëmije. Por kur fëmija ndihet keq ne duhet ti kushtojmë vëmendje, ti rrimë pranë. Sigurisht e rëndësishme është të bëjmë pyetje atij se përse ndihet keq? Për çfarë ka nevojë? Në mos i'a plotësofshim nevojat, të paktën t'ia kuptojmë. Ndëshkimi pa themelin e fortë të dashurisë dhe të disiplinës, nuk sjell gjë tjetër, veçse marrdhënie të dobët mes prindërve dhe fëmijëve. Fatkeqësisht kjo është një mënyrë e zakonshme e rritjes së fëmijëve tek ne sot. Padyshim edhe një nga arsyet pse fëmijët tanë kanë probleme social-psikologjike.

Mehmet Isufi, ikja e një njeriu të mirë

Ashtu si për familjarët e tij, edhe për stafin e gazetës sonë, ndarja e Mehmet Isufit nga jeta në muajin prill, qe sa e dhimbshme, aq edhe e papritur. Kur një zë vajtues gruaje e më pas zëri i dridhur i nipit në telefon, njoftoi se "Meta na la", e patëm të vështirë ta besonim. Na kishte lënë burri më i fuqishëm, shoku i dashur e bashkëpunëtori më i ngushtë i gazetës "Mokra", ku si kujtim ruajmë e shkrimet e botuara me autorësinë e tij dhe fotot e përbashkëta të bërë në takimet tona të rregullta.

Mehmeti u lind në fshatin Slatinë në vitin 1933, nga një familje fisnike me tradita të lashta patriotike. I gyshi i tij, Haxhi Isufi, ashtu sikurse edhe tre djemtë e tij, Murati, Hysemi dhe Aliu, ishin burra të shquar, atdhetarë, por që fatkeqësisht diktatura komuniste i përdoqi e i persekutoi për vite të tëra. I ati i tij, Aliu, si edhe pesë djem xhaxhallarësh, u burgosën si kundërshtarë të regjimit. Mbi 100 e ca vite burg kryen të gjithë sa bashku



pjesëtarët e fisit Isufi, ën vitet e regjimit komunist. Mehmeti, ashtu sikurse edhe vëllezërit e tij, edhe pse i shpëtoi burgut, falë zgjuarsisë, e punës së tij, sa në bujqësi e në sharrat e përpunimit të drurit në Bishnicë, përsëri ai vuajti persekutimin, izolimin dhe të gjitha pasojat që vinin nga ai regjim diktatorial, kur të cilësonte kulak, që ishte baras me "armik".

Mehmeti dallonte për kujtesën e tij të rrallë. Edhe pse

nuk kishte arsimin e duhur, ai e njihnte shumë mirë historinë e mokrarëve, si një studiues i vëmendshëm dhe i apasionuar. Jo pak nga rrëfimet e tij ne i kemi bërë tema të shkrimeve në gazetën tonë. Fatkeqësisht ai do të na mungojë të gjithëve në takimet e javës. Njëherësh ne e kujtojmë e do ta kujtojmë vazhdimisht si një njeri me zemër të madhe e mokrar i vërtetë.

Në çastet e fundit të jetës Mehmeti kreu një akt të mrekullueshëm: ai u la amanet djemve ta çonin të prehej në fshat, aty ku u lind, atje ai zgjodhi edhe banesën e fundit të prehej përjetësisht. Kështu të thërret zëri i vendlindjes. Ky është edhe mesazhi i fundit i Mehmet Ali Isufit. Qoftë i paharruar emri i tij. Ngushëllimet tona ia shprehim bashkëshortes së tij, Refies, vajzave dhe djemve, vëllezërve, nipërve e gjithë fisit të tij.

Haki Balliu, Flori Slatina, Pëllumb Zade, Zenun Fero, Sami Leka, Istref Haqhillari, Zabit Çuku, Llazi Tona



MËSUESI SHABAN SINANI ISHTE FISNIK E NJERËZOR

Ishte 14 marsi 2011, në ditë pranvere, u largua nga gjiri ynë, mësuesi Shaban Sinani, në Tiranë. Mësuesi u jep dije të tjerëve, dhe ky humanizëm duhet treguar kudo ku jepet mundësia. 35 vitet e kaluara në mësimdhënie nuk janë të pak për mësuesin Shaban Sinani. Mes bankave të nxënësve ka ecur për vite me radhë, që nga shtatori i vitit 1976, ku u caktua për herë të parë mësues, në fshatin Laktesh, Pogradec.

Shaban Sinani, lindi në vitin 1954, në fshatin Slabinjë, të rrethit Pogradeci, ku nëna e la jetim dy vjeç e gjysëm, mbaroi shkollën tetë vjeçare në fshatin e lindjes në vitin 1969, dhe për rezultate të mira, dërgohet të vazhdojë shkollën e mesme të përgjithshme në Pogradec, ku e mbaroi në qershor 1973, ndërsa në vitin 1973, dërgohet për të vazhduar studimet e larta, në specialitetin biokimi në Shkodër, ku diplomohet në korrik të vitit 1976.

Strukturat arsimore e caktojnë mësues në fshatin Laktesh të Pogradecit ku dha mësim, aty u dallua për mësimdhënie, i dashur, puntor, dhe nxënësit thoshin fjalët më të mira për të. Edhe shëndeti nuk e pengoi të vazhdonte punën si mësues në Laktesh, në këtë fshat me një infrastrukturë jo të mirë. Me përpjekje, ai arriti të vijë mësues në rrethin e Tiranës ku drejtoi për disa vite shkollën 8 vjeçare në Baldushk, dhe vazhdoi mësues. Fjalët më të mira për të kanë thënë kolegët e tij si Mevlud Buci, e tjerë. Një jetë e tërë e mbushur me dashuri për nxënësit, me dëshirën për të përçarur tek ata jo vetëm dije, por dhe kulturë e edukatë, me pasion për punën që bënte. Ai mbeti i nderuar në breza mësuesish e nxënësish. Mësuesi Shaban Sinani me modestinë e fisnikërinë e



tij, mbetet i nderuar nga njerëzit e thjeshtë dhe komuniteti i mësuesëve që flasin me respekt për atë që ai ka bërë. Si prind ishte i lumtur, bashkë me bashkëshorten Linditën, ata kanë mirëedukuar fëmijët Gersin e Entelën. Fëmijët mbaruan kualifikimet e larta në arsim. Entela ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Politike, Ana për Diplomaci në Gjenova të Italisë, ku ka marrë gradën mastër. Gersi vazhdon degën juridike në Universitetin Europian të Tiranës. Largimi nga jeta para kohe e Shabanit, na hidhëroi pa masë, hidhëroi babain Vait Sinani, vëllanë Isa Sinanin, dhe vëllezërit e njerëzit e tjerë të tij, të afërt, kolegët e tjerë. Lamtumirë mësues Shabani! E mbyll me thënie e mësuesit Mevlud Buci: "Nderime vëllezërit Sinani! Lum si ti moj Mokra bujare! Këta janë të thjeshtë, të vuajturit, të paharruarit tanë, bijtë e Slabinjës, Z. FERRO

NGJYRAT E DASHURISË

Nga Llazi TONA

Galeria e Arteve – Pogradec, pranë Qendrës Kulturore “Lasgush Poradeci”, është, pa dyshim, një nga institucionet më aktive, kulturore, e cila është një oaz jo vetëm për krijuesit e Pogradecit por edhe të Shqipërisë. Ekspozitat e hapura njëra pas tjetrës e tregojnë më së miri këtë gjë. Në kuadrin e festës së dashurisë “Shën Valentini”, më 12 shkurt të këtij viti çeli ekspozitën e arteve pamore – *Ngjyrat e dashurisë*. Artdashësit pamorë, kritikët dhe adhuruesit e këtyre vlerave artistike shikuan krijimtarinë e një numri të madh piktorësh profesionistë, amatorë, studentë, nxënës pogradecarë si: Anastas Konstandini, Gjergji Lako, Gëzim Begolli, Dhori Misioni, Ilir Basha, Marena Angjeli, Petraq Cici, Sofokli Koçi, Roza Kresta, Arben Haxholli, Asllan Kola, Petrit Larasi, Vait Kulla, Denisa Pako, Linda Kulla etj. etj.

Arti zë një vend të rëndësishëm dhe brenda tij arti figurativ ka një rol domethënës, të prekshëm dhe të ndjeshëm. Pa hyrë në labirintet e artit të shquar pogradecar, si traditë dhe si realitet veprues edhe në ditët e sotme, do të përqendrohemi vetëm te disa piktorë pogradecarë që njohin dhe ushtrojnë artin e pikturës – ka nga ata që janë bërë mjeshtrë të artit pamor.

Arti i paraqitjes së sendeve, të natyrës, të njerëzve dhe të veprave të tyre, me anën e vijave e të ngjyrave mbi sipërfaqet, zakonisht të sheshtë nëpër pikturat të vendosura në sallën e Galerisë së Arteve në Pogradec, është i një niveli të lartë shqiptar dhe evropian.

Jam tejet i kënaqur nga vizita që bëra në këtë sallë që kishte grumbulluar talentet më të njohur pogradecarë, që me veprat e tyre kishin sjellë gëzimet një e nga një, pas një pune kolosale për afirmim. Vetëm kështu mund të ecet përpara. Është një mësim që duhet të bëhet pjesë e qenësishme e kulturës dhe të ndërgjegjes së shqiptarëve.

Pata rastin të shoh këtu krijimtarinë e “Piktorit të merituar” pogradecar, i quajtur Anastas, që, po ta përkthesh në shqip do të thotë *Ringjallje*, por që këtu i thërrasin *Taso*. Lindur në Pogradec më 23 korrik të vitit 1954, diplomuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, në “pikturën monumentale”, bashkautor në zëvendësimin e mozaikut “Shqipëria” (Muzeu Historik Kombëtar – Tiranë).

Piktori Taso ka realizuar, brenda dhe jashtë vendit, një varg ekspozitash si në qytetin e lindjes e më pas në një sërë qytetesh të vendit si në Tiranë, Fier, Gjirokastrë, por edhe në Evropë. Në shumësinë e veprave të tij ai ka ilustruar edhe njerëzit e letrave, të mëdhenjtë e këtij qyteti e të mbarë Shqipërisë, Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli.

Dashuria është një ndjenjë e zjarrtë dhe e pastër që lind në zemrat e dy njerëzve të sekseve të kundërta dhe që i bën ta duan me gjithë shpirt e ta adhurojnë njëri-tjetrin. Pikërisht në këtë sallë të arteve pamore Piktori i merituar Taso apeloj përmes gjuhës së arteve figurative për zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes së natyrës pogradecare në veprat me motivin “Katër stinë”. “Pranvera”,



që është e para stinë e vitit, që vjen, fillim i një diçkaje, koha më e lumtur dhe më e gëzuar për gjallesat – njerëzit, bimët dhe kafshët. “Vera”, stina e dytë dhe më e ngrohta e vitit që vjen pas pranverës, ku fëshfërima e gjetheve, cicërima e zogjve, bima e dendur, zërat e njerëzve e bëjnë qytetin një vend poetik nga më të preferuarat në Shqipëri, por edhe mjaft tërheqës për turistët e huaj. “Vjeshta”, stina fund vere dhe fillim dimri, ku ditët fillojnë të shkurtohen, gjethet bien. Është stina që shoqërohet me shira të shpeshta, me mbledhjen e pemëve dhe perimeve që piqen e që bëhen pikërisht në këtë stinë. “Dimri”, stina e katërt dhe më e ftohta e vitit, ku kemi të bëjmë me një kohë të acartë, shoqëruar me dëborë e ngrica. Në popull thuhet: “Dimri ka beharin”, ose “Prodhimet e verës harxhohen në dimër” etj.

Kur e pyeta Tason se cila është domethënia artistike e këtyre stinëve, ai u përgjigj: “Katër stinë e vitit janë paraqitur përmes katër portrete femrash. Ato përbëjnë një unitet ngjyrash dhe mjetesh piktoristike, por janë edhe të ndryshme në ngjyra dhe në shprehje psikologjike. Ato vijnë së bashku si dhe veçmas nga njëra-tjetra. Bukruia dhe poezia bashkohen nga stili i lirë piktoresk, i cili zbulon ëndrrën muzikale të piktorit. Ato nuk janë natyraliste, por konceptualiste. Kjo gjë i afrohet pikturat me simbolizmin.

Mjeku Petraq, i cili është amator në fushën e pikturës, është nga ata që i sjell gëzimet një e nga një pas një pune madhore që shkon drejt afirmimit. Ka gati 30 vjet që pikturon dhe ka hapur mjaft ekspozita personale në qytetin e tij. Ai shquhet për stilin e tij të detajuar dhe naivist. Peizazhi pogradecar me rrugicat në dimër sjell atmosferë shumë intime të qytetit.

Nuk mund të lëmë pa përmendur Klitin, nxënësin e klasës së tetë, mjaft i talentuar dhe men të ardhme artistike. Ai ka sjellë në këtë ekspozitë punime simpatike dhe punon në kujdesin e piktorit Vait Kullolli.

Ardhja e Gëzim Begollit, amator veteran, nuk është rastësi, por logjikë e një pune intensive shumëvjeçare në fushën e pikturës, duke krijuar e kërkuar vazh-



dimisht, për të pasur zërin e tij, emrin e tij, profilin e pse jo, rrugën e tij. Gëzim Begolli spikat në peizazhin “Bregu i liqenit”, përmes një stili natyralist. Drita e pastër dhe modelimi mjeshtror me të cilat ka veshur këtë vepër artistike, ka lënë përshtypje ndër vizitorët.

Edhe Dhori Misioni ka sjellë në këtë ekspozitë punime të bukura me ngjyra dashurie dhe plot kujdes në trajtimin e peizazhit dhe të figurave. Piktura e Dhorit “Kuajt” sikur kërkon të thotë: Kali është simbol i njerëzimit. Cila është domethënia e kësaj pikturë?

Kali është kafshë shtëpiake e fortë dhe e shkathët, që i shërben njeriut për të hipur mbi të, për të mbartur mallra nga një vend në tjetrin, për të tërhequr mjete transporti, për të kryer beteja luftimi kalorësie. Kali është shumë i fuqishëm, prandaj jo më kot ai përdoret në teknikë si njësi matjeje në motorët me djegie të brendshme, të barabartë me 75 kg/m në një sekondë.

Këngëtarja me famë botërore, Tina Turner, kombinoi zërin e këngës së saj hipur mbi kalë me galop në vrapim. Kali përdoret edhe në garat sportive.

Para shumë vitesh kam parë një film artistik kushtuar një demonstrate të madhe kundër qeverisë cariste, e cila, për të shpartalluar atë, dërgon një trupë të madhe kalorësie ushtarake. Organizatorët e kësaj demonstrate urdhëruar demonstruesit që para se të mbërrinin kalorësit, të uletshin në shesh, duke u thënë atyre që kuajt asnjëherë nuk shkelin mbi njerëzit.

Kali është figura në lojën e shahut, që lëviz dy kuti përpara dhe një anash. Pak e dinë e shumë nuk e dinë shahu është gjimnastika e mendjes së njeriut.

Kali ka hijeshi dhe madhështi në art. Nuk janë të pakta skulpturat e peran-

dorëve më të shquar botërorë hipur mbi kuaj si Aleksandri i Madh i Maqedonisë, Konstandini i Madh i perandorisë së Evropës, mareshalli Zhukov i Rusisë, Skënderbeu, heroi Kombëtar shqiptar etj.

Sikurse dihet, arti karakterizohet nga e madhërishmja dhe e bukura. Duke parë krijimet e piktores profesioniste Marena Angjele, “Studentja”, “Nën çadër”, “Shenjtorja” etj. nga ky këndvështrim bie në sy mjeshtëria dhe finesa me të cilën autorja trajton temën nga madhështorja tek e bukura me një finesë tepër të hollë artistike. Ajo ka një ndjeshmëri mahnitëse ndaj ngjyrës dhe arrin të harmonizojë në akorde të kënaqshme nuancat dhe efektet kalorësiake. Jo vetëm kaq, por ajo është e pasur në mendime e fantazi, është korrekte dhe punon me shumë predispozitë.

Në disa piktura të kohëve të fundit, në ekspozitën e arteve pamore në sallën e Galerisë së Arteve në Pogradec kemi të bëjmë me një stil tjetër, stil ky që shënon një epokë të thellë shkencore.

Nadja Konstandinova, me tablonë e madhe në dimension, por edhe me frymë moderne ajo zbërthen realitete të patrajtuara nga të tjerët. “Bar Kodet” e saj pasqyrojnë simbolet e teknologjisë moderne siç janë në numrat kompjuterike në simbolet estetike dhe shumë befasese. Stili është antikonformist.

Më tërheqin vëmendjen disa krijime të piktorit të talentuar pogradecar Gjergji Lako. Termi Gjergj rrjedh nga greqishtja, që në shqip do të thotë arë për tokë buke. Të katër krijimet e tij na sjellin bukurinë e femrës, asaj figure tashmë të trajtuar në letërsi dhe art për shekuj me radhë, për të treguar vlerat e mëdha njerëzore; ato përfaqësohen nga tri femra të bukura, të cilat ishin: Poezia, arti, muzika. I afrohem piktorit profesionist dhe e pyes së çfarë kërkon të thotë ai me veprat e tij.

-Piktura për mua, - thotë Gjergji, - është një formë dhe frymëzim për t'u shprehur me mjetet e artit. Njeriut i ka rënë në pjesë gjithmonë një kohë, e cila mund të jetë e qetë, apo të kalojë kohën me kulturë, miqësi, dashuri, urrejtje e zjarr. Në këtë kohë jeton edhe artisti, i cili vjen nga një mision njerëzor me aftësi të ndiejë jetën, dashurinë, natyrën, të besojë në vlerat më të mira njerëzore, që me talentin e tij do të krijojë vepra për kohën, ëndrrën, besimin për të ardhmen e shoqërisë. Te krijimet e mia kam një ide të përgjithësuar, që është Lira, femër nudo, e cila shpreh lirinë, bukurinë, pasionin, dritat e trupit të saj, që kanë tërhequr mijëra artistë në botë.

Artisti në kohë tranzicioni apo ndryshimi, siç ndodh në vendin tonë në fund të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI, shpejton të sjellë në art edhe pjesë të shpirtit, të cilit i ka munguar lira. Me këtë fjalë të bukur, kam parasysh gjithçka.

Piktorët pogradecarë janë artistë të mrekullueshëm, idealistë të mirë, janë luftëtarë trima për artin, që nuk tremben nga realiteti, nga mos dija, por edhe nga e vërteta. Ata janë kërkues, janë këmbëngulës, janë krenarë, janë sfidues, janë konkurrues, debatues, të tejdukshëm. Por thelbësorja është se ata kanë thellësinë e pafund të mendimit të panjohur drejt realiteteve që do të vijnë më shpejt ose më vonë. Ata janë të shumtë dhe është e pamundur t'i përshkruajmë në këtë shkrim. Për ta duhet një libër më vete.